

Ky projekt është i mbështetur nga Agjencia Ndërkombëtare e SHBA-ve - USAID dhe bordit ndërkombëtar për hulumtim dhe shkëmbim - IREX dhe implementuar nga partneri lokal Qendra për burime dhe trajnime në avokim - ATRC. Qëndrimet e shprehura në këtë publikim, nuk pasyrojnë qëndrimet e USAID-it, IREX-it dhe ATRC-së.



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERICKOG NARODA



ORG-MR
MILENIUMI I RI

NON-GOVERNMENTAL
ORGANIZATION
ORGANIZATE
JO-QEVERITARE

MERRNI PJESË
NË PROCESIN E BËRJES SË
STATUTIT TË KOMUNES SUAJ

MERRNI PJESË NË PROCESIN E BËRJES SË STATUTIT TË KOMUNËS SUAJ

Statuti është akti më i lartë juridik i komunës. Ai rregullon kompetencat dhe pushtetin e komunës, pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të qytetarëve në mbledhje, aktivitetet dhe mënyrën e vendosjes në punët publike, organet e Komunës, dhe Shërbimin civil, të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të Kuvendit, administrimin financiar, konfliktin e interesave, aktin formal, dokumentet zyrtare dhe informatat.

PETICIONI - MJET PËR REALIZIMIN E KËRKESAVE TUAJA

Peticioni është kërkesë me shkrim që i adresohet Kuvendit Komunal (Komunës), rreth cilësdo çështje që ka të bëjë me përgjegjësitë dhe kërkesat e Komunës, me qëllim që ajo të ndërmarrë ndonjë veprim ose të përmbahet nga marrja e ndonjë veprimi.

KUSH KA TË DREJTË TË PARAQESË PETICIONIN

Secili qytetar apo organizatë ka të drejtën për t'i drejtuar petition Kuvendit Komunal lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me përgjegjësitë dhe kompetencat e Komunës.

ÇFARË JU SHËRBEEN PETICIONI

Përmes tij ju mund të zgjidhni problemin e lagjes, fshatit apo rrugës ku banoni, e cila është e pa asfaltuar, aty ku rrezikohen fëmijët tuaj nga automjetet, mungesën e trotuareve, rregullimin e hapësirave të gjelbra, ndërtimin e shkollës, ambulancës apo shtëpisë së kulturës dhe shumë çështje tjera !

SI TA BËNI PETICIONIN

Përderisa keni identifikuar çështjen që mendoni ta ndryshoni, mund t'i mblidhni nënshkrimet e banorëve të lagjes suaj (atyre me të drejt vote), dhe pasi t'i keni mbledhur shumicën e nënshkrimeve petitionin mund t'ia dërgoni Kuvendit Komunal, përkatësisht Shefit të Drejtorisë së Administratës dhe Personelit i cili në afat prej 30 ditësh duhet ta prezantojë atë para Kuvendit Komunal. Kuvendi Komunal, mund ta referojë për shqyrtim në Komitetin përkatës, dhe ju si parashtues e keni të drejtën e pjesëmarrjes në mbledhjet e komitetit përderisa shqyrtohet kërkesa juaj.

VENDIMI PËRFUNDIMTAR

Vendimin përfundimtar për çështjen e petitionit e merr Kuvendi i Komunës, në afat prej 6 (gjashtë) javësh nga dita e prezantimit të petitionit në Kuvend. Vendimi do të arsyetohet me shkrim dhe po ashtu do tu komunikohet parashtuesve të tij.

PROBLEMI QË KËRKON ZGJIDHJE

Përderisa në statutin e kaluar të komunës së Prishtinës, ka ekzistuar një kufuzim prej 10.000 nënshkrimesh, në mënyrë që një petition të jetë i fletshëm. Në draft-statutin e komunës, Komisioni për Statutin ka bërë disa ndryshime. Peticioni në nivel të qytetit duhet të ketë 5.000 nënshkrime, ndërsa peticioni në nivel të lagjes apo fshatit duhet të ketë 500 nënshkrime të banorëve me të drejt vote. Por, edhe numri prej 500 nënshkrimesh është i lart për një lagje të vogël apo për një fshat që ka numër të vogël të banorëve. Prandaj për të thënë fjalën tuaj :

Komuna e Prishtinës do të organizoj diskutime me qytetarë, bisnese, OJQ dhe media për të marrë mendimet e tyre për përmbajtjen e statutit të Komunës. Pjesëmarrja juaj është e rëndësishme që statuti si akti më i lartë i komunës, të jetë në harmoni me kërkesat dhe nevojat e qytetarëve dhe në përputhje me rregulloren 2007/30.

Merrni pjesë në diskutimet për hartimin e statutit të komunës së Prishtinës.

Thuaje fjalën tënde ! Bëhu vendimmarrës !
Është e drejtë e jotja !

Për më shumë informata kontaktoni :
038/545 633 ose në ojamileniumiiri@yahoo.com